



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.12.2019, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtim i projektvendimit “Për propozimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Lefter Maliqi, Alban Zeneli, Edmond Rrushi, Ylli Shehu, Arben Elezi, Elona Gjebrea, Luan Duzha, Anduel Xhindi, Myslym Murrizi, Nimet Musaj, Arlind Çaçani, Luan Harusha dhe Elena Xhina.

Mungojnë:

Paulin Sterkaj.

Të ftuar:

Petro KOÇI - Zëvendësministër i Mbrojtjes

Haki ÇAKO- Drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave Civile

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirdita! Hapim mbledhjen e komisionit. Sot ne rend dite kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për propozimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore”.

Së pari, na detyron Kushtetuta. Kushtetuta e ka shprehur qartë këtë gjë, por, besoj se pas këtij momenti është e rëndësishme që ne të kemi justifikimin e plotë publik në lidhje me nevojën që kjo gjendje e fatkeqësisë natyrore të zgjatej. Besoj se nga fjala juaj dhe nga ajo që mund të ndjekim çdo ditë, për shkak se të dhënat përditësohen çdo ditë, në lidhje me verifikimet që janë duke u kryer në terren, kuptohet qartë që është një situatë, që, natyrisht, duhet të vijohet të përballohet nëpërmjet masave të jashtëzakonshme, të cilat konsistojnë në faktin që nuk mund të përfshijmë në përballimin e kësaj situate thjesht strukturat që janë përgjegjëse drejtpërdrejt, por edhe struktura të tjera. Kështu që, në rastin konkret, angazhimi duhet të jetë më se i plotë deri në momentin fundor, kur të ketë filluar akomodimi ose rehabilitimi i plotë i të gjitha familjeve dhe i të gjithë njerëzve që u dëmtuan nga tërmeti i datës 26 nëntor.

Megjithatë, dua t’ia jap fjalën kolegut Vorpsi dhe më pas, nëse kolegët kanë pyetje, patjetër që do t’i ezaurojmë të gjitha pyetjet.

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zoti Vorpsi!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti Zëvendësministër, e dëgjova me vëmendje fjalën tuaj për sa i përket projektvendimit, i cili, ashtu siç e citoi edhe kryetarja, është një detyrim i Kuvendit të Shqipërisë gjithmonë, kur kalon faza e parë, dhe vendimi i qeverisë përkon me fazën e parë të 30-ditëshit të emergjencave civile.

Unë nuk dua të zgajtem shumë në statistika, natyrisht, ato janë fakte që janë të njohura edhe për opinion publik, por edhe për ju. Ne kaluam një fazë të parë, duke pasur parasysh që ditët e parë pas tërmetit është faza e kërkim-shpëtimit dhe e verifikimit.

Janë hartuar dhe janë zbatuar masat afatshkurtra të rregullimit të pasojave, me qëllim sigurimin e jetës dhe të shëndetit të individëve. Tashmë lind nevoja të përshkallëzohet ky angazhim dhe të jetë i jashtëzakonshëm, ashtu siç e përmendët edhe ju. Në situata të tilla faza e dytë është më e rëndësishmja, sepse kërkon një angazhim më të madh të koordinimit institucional midis institucioneve qendrore e atyre vendore dhe kërkohet një angazhim jo i zakonshëm, siç e përmendët edhe ju, për ta kaluar këtë fazë dhe për të kaluar në fazën e rindërtimit. Pra, qëllimi i këtij projektligji është zgjatja deri në datën 31 mars të vitit 2020 të

kësaj gjendjeje të jashtëzakonshme të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë. Objektivi i këtij projektvendimi është garantimi i sigurisë së jetës së banorëve, sigurimi i veprimtarisë normale për jetën e komuniteteve të prekura në këto zona, si dhe marrja e masave parandaluese, mbrojtëse, rehabilituese në infrastrukturën dhe mjedisin e prekur nga situata e krijuar.

Unë dua të shfrytëzoj rastin t'ju falënderoj për angazhimin tuaj si Ministri i Mbrojtjes, por edhe të gjitha strukturat e emergjencave civile për punën e jashtëzakonshme që keni bërë gjatë kësaj situatë, një pjesë të komunitetit të emergjencës siç jeni ju dhe, natyrisht, të gjitha strukturat e qeverisë, të cilat e përballuan me sukses këtë situatë të vështirë.

Ndaj, edhe një herë doja t'u bëja thirrje të gjithë kolegëve deputetë që ta miratojnë këtë projektvendim, i cili do të krijojë një moment të mirë për të menaxhuar këtë situatë posttraumë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Vopsi!

Fjalën e ka zoti Musaj.

Më pas fjalën e ka zoti Maliqi.

Nimet Musaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Faleminderit, zoti Drejtor!

Dua t'ju vlerësoj dhe t'ju përgëzoj për këtë situatë ku ju keni qëndruar pranë qytetarëve të të gjitha këtyre zonave të dëmtuara. Keni dhënë kontributin maksimal me punën që keni bërë. Si komision kemi kënaqësi që jemi sot bashkë këtu. Duke shkuar në çdo familje të atyre banorëve dhe duke e parë të gjithë fatkeqësinë me detaje, është normale shtyrja e këtij afati tremujor, që gjithçka t'ju vijë sa më mirë në ndihmë atyre qytetarëve dhe gjithçka të bëhet në kushte normale dhe ndoshta akoma më mirë se sa kanë qenë deri dje këta qytetarë. E vlerësoj këtë angazhim e këtë punë dhe do ta votoj pro për shtyrjen e këtij afati.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Musaj!

Fjalën e ka zoti Maliqi.

Lefter Maliqi – Faleminderit, zonja kryetare!

Faktikisht, deputetët si të maxhorancës edhe të opozitës, kur bëhet fjalë për fatkeqësi, sigurisht jemi në mbështetje të banorëve të dëmtuar për zgjidhjen e problemeve sa më shpejt, por disa gjëra duhen thënë siç duhet, pasi ky parlament nuk e ka pasur problem,

sidomos këto vitet e fundit, që të miratojë çdo vendim të qeverisë. Problemi qëndron që ky parlament nuk ka pasur fuqi në këta 2 vjetët e fundit që të drejtojë qeverinë që ajo të jetë më e përgjegjshme në këtë fatkeqësi të madhe. Domethënë, qeveria vetëvendosi, madje vendosi një fond qesharak rreth 20 miliardë lekë nga buxheti i shtetit, ndërkohë që sytë, mendjen dhe shpresat i ka te donatorët vendas dhe të huaj, te solidariteti i Shqiptarëve, te shteti turk dhe te Bashkimi Europian, ndërkohë që vetë vazhdon me papërgjegjshmërinë e saj. Nëse janë dhënë 20 miliardë fond nga buxheti i shtetit, mbi 300 miliardë u janë dhënë PPP-ve apo edhe fonde shtesë, si Kryeministria që ka 10 milionë euro më shumë se vitin e kaluar. Domethënë, duket se edhe me këtë fond, që do ta miratojmë 3 muaj, madje dhe më shumë ta miratojmë, ne si shqiptarë dhe ju si media do të shikoni çdo ditë ERTV-në e famshme: *show*, aktrim, Kryeministri që bën punën e drejtorit të Emergjencave Civile, të drejtuesit të shtabeve të përgjithshme, që bën detyrën e kryebashkiakut dhe të gjitha me radhë, se të gjithë i dimë. Kështu që serioziteti për këtë fatkeqësi duhet të jetë shumë më i madh madhe dhe ne si Kuvend duhet të marrim nismën (nëse jemi 10, 15 apo 20 deputetë të opozitës, mbase ka edhe deputetë të tjerë të maxhorancës të përgjegjshëm, por për shkak të këtij sistemi nuk ngrenë zërin) që ta detyrojmë qeverinë që të anulojë tenderët për investime në infrastrukturë apo investime të tjera, që janë me shumicë, për të kaluar menjëherë, me procedurë të përshpejtuar, për të filluar rindërtimin e atyre zonave të prekura. Drejtësinë nuk e dimë se si po funksionon, sepse pamë disa ndalime, arrestime *show*, ndërkohë që tek aktorët e rëndësishëm politikë, të cilët kanë dhënë lejet, betonin apo kanë miratuar të gjitha këto abuzime, ashtu siç ishte edhe rasti i Thumanës, nuk dihen ende përgjegjësitë, pra se kush u tha atyre banorëve që të futen në banesë pas 21 shtatorit e me radhë. Prandaj, ne jemi këtu për të ngritur zërin për të vërtetën. E vërteta është si drita e diellit, qeveria i do fondet e saj për PPP-të e oligarkëve, ndërkohë që sytë dhe mendjen i ka tek aktrimi në televizor.

Kohët e fundit Kryeministri na është bërë si prift. Me një fjalë, po i bën të gjitha: po puth pleq e plaka, po pret shirita, po merr edhe këta donatorët me vete, sikur po i bën ky të gjitha, ky është gjithçka dhe ne të tjerët jemi pa vlerë, parlamenti e të gjitha me radhë. Prandaj duhet seriozitet.

Unë mendoj se i gjithë ky *show*, 3 muaj, 4 muaj apo 5 muaj është për të tërhequr vëmendjen nga skandalet e radhës që po e pasojnë këtë qeverisje, duke filluar edhe me ligjin e fundit antishpifje për gazetarët, me goditjen që po u bën socialistëve, ku sot Arben Malaj ishte te Komisioni i Ekonomisë, socialist i ndershëm si Petroja është edhe ai dhe të gjitha me radhë. Prandaj unë them se kjo qeveri nuk është e përgjegjshme. Sigurisht, unë jam dakord të shtyhet 3 muaj, të shtyhet 6 muaj, por mos të përdoret për *show* televiziv dhe për aktrim.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Koçi!

Petro Koçi – Atëherë, nëse më lejoni, po bëj një koment.

Së pari, në emër të qeverisë, i mirëpres të gjitha qëndrimet konsensuale për sa i përket dhënies së pëlqimit të Kuvendit ndaj kërkesës së saj për të shtyrë gjendjen e fatkeqësisë natyrore.

Për sa u përket komenteve të tjera, sigurisht, mendoj se ky nuk është rasti për të bërë opozitë. Mendoj se në këto raste sigurisht që ka nevojë për të bërë kërkesa, propozime konstruktive, por qeveria është e angazhuar për të bërë maksimalen në reagim ndaj situatës së krijuar nga tërmeti, i cili, ndryshe nga ngjarja e Gërdecit, nuk ka lidhje me qëndrime dhe me vullnete shtetërore, sepse kam parë disa komente që akuzonin shtetin për viktimat e tërmetit, ndërkohë të njëjtët persona apo subjekte e kanë cilësuar ngjarjen e Gërdecit aksident teknologjik.

Mendoj se për sa i përket buxhetit qeveria bëri maksimalen, duke reduktuar një pjesë projektesh, që ishin të rëndësishme për vitin e ardhshëm, për t'ia kaluar situatës emergjente të krijuar.

Për komentet e tjera që lidhen me shpifjen e të tjera, mendoj, kjo është konsideratë personale, se për shpifjen Shqipëria ka vite të tëra që është në emergjencë. Nuk është se erdhi tërmeti dhe ne po shijojmë emergjencën e shpifjeve. I mirëkuptoj shqetësimet e disave në lidhje me paketën kundër shpifjes, por të njëjtët njerëz nuk kanë asnjë propozim se si zgjidhet kjo puna e shpifjes që kësaj radhe solli edhe një viktimmë. Unë e kuptoj shumë mirë që shpifja bën dikë me djalë teze, kur nuk ka teze, por kam përshtypjen se ky debat në lidhje me këtë paketë që bën opozita është më shumë një përpjekje për të anashkaluar problemet e vërteta që ka vendi, ku problemi kryesor është emergjenca e krijuar pas tërmetit të 26 nëntorit. Pra, këtu nuk bëhet llogari karrigesh edhe votash, por bëhet llogari për t'u angazhuar të gjithë në përballim të kësaj situatë. Kryeministri e ka për detyrë që të jetë i pari dhe të jetë instrumenti kryesor në emër të shtetit për ta përballuar situatën. Mendoj se është një shembull pozitiv dhe nuk ka lidhje me *show-n*, sepse nuk bën dot *show* 16 orë njeriu. Ai që bën *show*, mund të bëjë një spektakël diku, por të punojë njeriu nga mëngjesi deri në darkë, duke shkuar zonë më zonë, duke drejtuar mbledhje, duke marrë vendime, duke bërë propozime, kjo gjë nuk ka lidhje me *show-n*. Kështu që t'i japim Çezarit atë që i takon, pra në rastin konkret qeveria po bën maksimalen.

Jam një nga ata që mendoj se kontributi i të gjithëve është i mirëpritur, qoftë edhe kontributi politik i opozitës, së cilës iu propozua që të vinte në një tryezë komunikimi të përbashkët për të dhënë një shembull, siç e japin të tjerët. Dua t'ju kujtoj se herën e fundit,

kur u bë një sulm terrorist në Londër, në ceremoninë që u bë me rastin e varrimit të viktimave ishin bashkë si kreu i qeverisë, ashtu edhe kreu i opozitës. Kjo nuk do të thotë se ka ndonjë ndryshim në marrjen e vendimeve dhe ligjeve, por është një efekt shumë i madh shpirtëror që sjell më shumë energji tek të gjithë njerëzit, tek e gjithë shoqëria që merret me përballimin e kësaj situatë të krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit.

Kështu që dua t'i falënderoj të dy deputetët e opozitës që dhanë konsensusin në lidhje me shtyrjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Ndërkohë, do të bëj apel për më shumë konstruktivitet në këtë situatë të krijuar, e cila nuk mund të bëjë llogaritë e partive dhe të politikanëve, por bën llogaritë e hallexhinjve, të atyre që sot janë të pastrehë dhe presin që angazhimi i qeverisë për të rindërtuar banesat, qoftë në formën e pallateve, qofte në formën e banesave individuale të realizohet sa më shpejt. Për të realizuar këtë ne do të bëjmë gjithçka, jo vetëm do të shfrytëzojmë buxhetin e shtetit, por edhe ndihmat nga komuniteti ndërkombëtar, sepse kjo, krahasuar me ekonominë, me kapacitetin shoqëror dhe institucional që ka Shqipëria, është një fatkeqësi e një përmase shumë më të madhe. Prandaj është e nevojshme të kemi edhe solidaritetin ndërkombëtar.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Jam shumë dakord që këtu ka perceptime të ndryshme, sepse vetë situata e krijuar për shkak të tërmetit është një situatë komplekse, por e rëndësishme është, që në fund të ditës, përtej monologëve, ne të bëjmë atë që mund të bëjmë.

Në fakt, dua të falënderoj disa kolegë të Komisionit të Sigurisë që kanë qenë jo thjesht ditën e tërmetit nëpër zona, por kanë qenë të angazhuar edhe më pas. Pavarësisht se përgjegjësitë konkrete që na jep ne ligji në rastin konkret mund të jenë shumë më të vogla, në raport me ato që kanë institucione të tjera ekzekutive, përsëri të qenit atje ndihmon që njerëzit, ata që na kanë zgjedhur ne për të qenë këtu, të mund të na drejtohen lirshëm për të gjitha shqetësimet dhe për të gjitha kërkesat e tyre. Besoj se kjo lloj mbështetje nga ana jonë, minimalisht si anëtarë të zgjedhur të këtij komisioni, duhet të vijojë në të gjitha zonat, të cilat janë prekur nga tërmeti, pra në Tiranë, në Durrës dhe në Lezhë. Pavarësisht se një pjesë nuk jemi drejtpërsëdrejti deputetë që punojmë në ato zona, gjithsesi, ne jemi të zgjedhur, ne jemi persona publikë dhe, si të tillë, nuk mund t'i mungojmë këtij angazhimi.

Besoj se më e rëndësishme është që të kontribuojmë në këtë fazë që afati, për të cilin na duhet sot të japim pëlqim, të jetë i tillë që të mund t'i plotësojë kërkesat themelore të të gjithë banorëve që u prekën nga tërmeti. Në fakt, kjo do të ishte gjëja që do të na interesonte më shumë të gjithëve, pra të kuptonim që ju po kërkon një afat tremujor, deri në fund të

marsit 2020, por çfarë do të bëhet deri në fund të këtij afati? Çfarë do të shikojmë deri në fund të marsit 2020?

Çështja tjetër nëse presim apo nuk presim ndihma nga të tjerët, nuk është më çështje diskrecioni, është një çështje shumë e qartë që ligji për mbrojtjen civile e vendos, sepse e detyron shtetin t'i referohet mekanizmit europian për mbrojtjen civile. Shumë mirë që të paktën në këtë pikë ne u gjendëm në kohë, sepse, duke pasur ligjin, patëm mundësinë që ta përdorim këtë mekanizëm dhe ta shfrytëzojmë të gjithë ndihmën. Besoj se të diskutojmë më pas se çfarë problematikash kanë pasur dhe vijnë të kenë emergjencat civile, kjo kërkon një kohë më të gjatë se sa kaq. Këto nuk janë probleme të krijuara thjesht dhe vetëm për një ditë, për një muaj, por janë probleme të një sistemi të tërë 30-vjeçar. Kështu që duhet të jemi sa më objektivë në këtë histori, duke u munduar që të ndërtojmë punë. Kur diskutuam buxhetin e vitit 2020 bëmë një përpjekje, që, besoj, pak ra në vëmendje të medieve, që ta përqendronim në një vëmendjen e Ministrisë së Financave, të autoriteteve të pushtetit lokal që ato të dedikojnë fonde për emergjencat civile, sepse natyrshëm situata të tilla nuk mund të përballohen, sikur të ishte diçka e zakonshme. Natyrisht që është diçka që shkon përtej fuqive. Kjo është për Shqipërinë dhe për cilindo vend që ndodhet në situata të tilla, por kjo nuk mund të justifikojë faktin që të mos ketë reagim. Patjetër që duhet të ketë reagim dhe në momentin që kalohet faza e parë, nuk duhet të shërbejë si një moment e rënies së intensitetit të punës, përkundrazi, puna duhet të vijojë me intensitet akoma më të lartë, sepse edhe problemet që shfaqin njerëzit e prekur nga tërmeti nuk janë më të njëjtat si ditën e parë apo ditën e dytë. Problemet shtohen. Kështu që duhet paraprirë me struktura që i trajtojnë këto probleme, natyrisht edhe me kohën e përshtatshme në dispozicion, që angazhon masa të nevojshme për ta përballuar të gjithë këtë situatë.

Mua më vjen mirë, dhe nuk kisha ndonjë dyshim që nuk do të kishim ndonjë lloj konsensusi në këtë komision apo edhe në çdo komision tjetër për të dhënë pëlqimin për zgjatjen e afatit. E rëndësishme është që ky afat të mos jetë thjesht formal, por të jetë një afat që nga ana juaj presupozohet të përmbushet çdo ditë me punë dhe me angazhim ndaj të gjithë njerëzve që e pësuan nga kjo situatë e kësaj fatkeqësie natyrore.

Lefter Maliqi – Faleminderit!

Na hutuat me këto reklamat e politikës. Sigurisht, ne të opozitës konsensusin për shtyrjen e afatit do ta japim, por këtu nuk ka të bëjë fare opozitarizmi, këtu ka të bëjë realiteti për të gjithë dëmin dhe për të gjitha ato viktimat. Unë e thashë shqip më duket, pra thashë se ne jemi republikë parlamentare. Le të më thotë ndonjë nga deputetët e maxhorancës se kush nga ju e ka fuqinë të marrë nismë, të drejtojë qeverinë, të rishikojë fondet, buxhetin e shtetit

të vitit 2020, se nuk janë 20 miliardë lekë, por janë mbi 300 miliardë. Unë po ju them ju miratuat 10 miliardë lekë shtesë vetëm për luksin kryeministrit. Ku di unë çfarë ka shtuar ai për të mbajtur në vëzhgim portalet, mediet e të gjitha me radhë. Kjo është e vërteta. Përsëri unë thashë, dhe nuk kemi pse e lidhim me Anglinë, sepse jemi shumë poshtë, as me Bashkimin Europian, sepse jemi shumë poshtë, se çfarë bën opozita është punë e saj, nuk jam në mbrojtje të opozitës, që jam në mbrojtje të vendosjes të drejtësisë së viktimave dhe në mbrojtje të dëmshpërblimit të atyre njerëzve. Tani ne të gjithë po shikojmë, troç muhabetit, *show*, pra Kryeministri po i bën të gjitha punët: po na vishet si prift, si hoxhë, ku e di unë se çfarë po bën. Drejtori i emergjencave, Hako, është shumë i aftë, e njoh shumë mirë, por nuk ka çfarë të bëjë, sepse ia merr ai të gjitha kompetencat. Ka vënë edhe disa zëvendësministra pa përvojë që të drejtojnë shtabet. Domethënë, na merr ca donatorë, e shtyn 3 muaj, e shtyn 6 muaj, do të presë disa shirita, do të futet në ndonjë shtëpi me ndonjë donator për t'iu hedhur hi në sy shqiptarëve. Ndërkohë, fondi është mbi 300 miliardë lekë, që janë vetëm për PPP-të, për rrugët, për investimet e të tjera me radhë. Ne qenkemi të kënaqur me 20 miliardë lekë! Domethënë, dyfishi i 10 miliardit që i janë shtuar Kryeministrit vetëm për këtë vit! Pse nuk i heq ai? Për çfarë i do ai të gjithë ata që ka aty? Ik shikoni se sa k vetëm për të mbajtur median nën kontroll, portalet. Domethënë, kjo është diktaturë, pra unë po ju them juve, meqenëse po thoni për *show*, a mban përgjegjësi Kryeministri dhe kjo qeveri për shpifjet elektorale të viteve 2013 dhe 2017? Kjo është e vërteta. Sensibilizimi...

Ermonela Felaj – Zoti Maliqi, ju lutem, kjo nuk ka lidhje me këtë që po diskutojmë.

Lefter Maliqi- Ka shumë lidhje, sepse janë tallur me viktimat...

Ermonela Felaj- Ju lutem, mos përsërisni ato që thatë një herë!

Lefter Maliqi- Janë tallur, 20 miliardë nga buxheti i shtetit është qesharake, pasi 10 milionë mblodhi Elvis Naçi, 3 miliardë një tjetër dhe kjo është turp. Çfarë bëjnë tani?! E shtyjnë 3 muaj për *show*, për të kaluar të gjitha ato skandalet dhe u morën sot me socialistin Arben Malaj. Ju nuk keni fuqi...

Ermonela Felaj – Ju lutem, zoti Maliqi, jua ndërpres fjalën dhe po ia kaloj zonjës Dhima, sepse ju e ezauroat kohën tuaj të diskutimit dhe të pyetjeve.

Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Zëvendësministër, për prezantimin, punën dhe angazhimin jo vetëm tuajin, por të të gjithë stafit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe, njëkohësisht, gjithë qeverisë, e cila është angazhuar në këtë situatë të tërmetit!

Njëkohësisht, unë dua të falënderoj edhe deputetët e pozitës dhe opozitës, të cilët kanë qenë prezentë në të gjitha qarqet e dëmtuara!

Ligji për mbrojtjen civile parashikon se gjendja e fatkeqësive natyrore kalon disa faza menjëherë pas ndodhjes së fatkeqësive natyrore: me fazën e kërkim-shpëtimit, besoj se kjo fazë ka përfunduar; verifikimin e pasojave dhe fazën finale, atë të rregullimit të pasojave nëpërmjet procesit të rindërtimit.

Sot ju vini me një projektvendim për shtyrje afati të gjendjes së fatkeqësisë natyrore me tre muaj. Pyetja ime është: a keni ju një plan apo program pune të detajuar të punës që do të bëni ju si ministri dhe strukturat tuaja në këtë periudhë 3-mujore deri më 31 mars dhe a mendoni se ky afat është i mjaftueshëm për të përfunduar apo do të duhet më shumë se 3 muaj?

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Faleminderit, zonja Dhima!

Urdhëroni, zoti Koçi!

Petro Koçi – Në gjykimin e qeverisë, pas përvojës së krijuar nga momenti i shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, duket e logjikshme që ky afat të shtyhet deri më 30 mars dhe këtu duhet të kihet parasysh jo vetëm angazhimi i institucioneve, të cilat përfshihen drejtpërdrejt me përballimin e situatës, por edhe detyrimet ligjore që ka në përgjegjësi shoqëria, individët dhe subjektet në raport me situatën e krijuar, sepse, siç e dini, gjendja e fatkeqësisë natyrore krijon më shumë mundësi për të detyruar të gjitha subjektet, duke filluar nga ato shtetërore deri tek ato private, për t’iu përgjigjur në nivelin e duhur përballimit të situatës. Pra, paraprakisht mendohet se kjo gjendje duhet të zgjasë deri më 30 mars. Çfarë do të ndodhë më pas do të vlerësohet hap pas hapi, por besojmë se deri në përfundim të kësaj periudhe gjendja do të jetë më e stabilizuar. Strehimi i përkohshëm i banorëve, të cilët janë të pastrehë, do të jetë i stabilizuar dhe ndërkohë do të ketë filluar procesi i rindërtimit. Pra, në atë periudhë do të duken efektet e para të lehtësimit të situatës nga efekti i rindërtimit, sepse në çdo banesë të rindërtuar do të kthehet familja, e cila është e pastrehë, që do të thotë më pak ngarkesë në strehimin e përkohshëm, në trajtimin ushqimor shëndetësor e të tjera. Ky është gjykimin e këtij momenti, pas reflektimit që ka bërë qeveria në përputhje me përvojën dhe të gjithë praktikën e deritanishme në përgjigje të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të vendosur sipas Kushtetutës nga vetë qeveria në afatin 30 ditor. Prandaj kërkohet kjo shtyrje, e cila realizohet vetëm duke dhënë pëlqimin Kuvendi, në bazë të kërkesës që bën qeveria. Ndërkohë që Forcat e Armatosura, siç ju e dini, janë pjesë mbështetëse e këtij procesi, pra e përballimit të emergjencës. Përveç të tjerash, ne jemi duke asistuar IKMT-në në prishjen e

pallateve dhe banesave, të cilat janë shpallur jo vetëm të pabanueshme, por që nuk rikuperohen me ndërhyrje themelore, duhen rindërtuar nga e para dhe një sërë praktikash të tjera, të cilat janë detyrim i Forcave të Armatosura për të përballuar emergjencën në përgjigje të situatave, kushteve dhe kërkesave që bën pushteti vendor, prefektura dhe shtabet e emergjencës, duke shkuar deri te shtabi i krijuar në Durrës dhe pastaj Komiteti Ndërministror i Emergjencës Civile dhe vetë Drejtoria e Agjencisë Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Pra, janë të gjithë këta mekanizma, të cilët, herë pas here, bëjnë kërkesa ndaj Forcave të Armatosura për t'iu përgjigjur. Kjo duke pasur parasysh edhe faktin se Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit është në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Pra, Forcat e Armatosura dhe vetë ministria janë marrë me pritjen, menaxhimin dhe shpërndarjen e ndihmave, që kanë ardhur në çadra dhe në asetet mbështetëse të strehimit të përkohshëm të familjeve të pastreha tashmë.

Ermonela Felaj- Faleminderit, zoti Koçi, për përgjigjen!

Fjalën e ka zoti Harusha.

Luan Harusha- Faleminderit, kryetare!

Falënderoj ministrinë, drejtorin e Emergjencave, zotin Çako, qeverinë dhe të gjitha institucionet që janë marrë me këtë punë!

Ngushëlloj familjarët që kanë humbur familjarët e tyre. Dua të them se në zonën e Shkodrës ka pasur disa verifikime për dëme në disa banesa. A jeni në dijeni për këtë pjesë? Në qoftë se po, aty duhet një grup verifikimi inxhinierësh. Edhe Bashkia Shkodër ka bërë verifikimet me një grup inxhinierësh, por ato janë paraprake.

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Po, zoti Çako.

Haki Çako – Faleminderit, të nderuar deputetë të Komisionit të Sigurisë!

Së pari, më lejoni t'ju falënderoj për mbështetjen e jashtëzakonshme që i keni dhënë përpara se të vijë kjo fatkeqësi natyrore!

Më duhet të përcjell të gjithë falënderimin tim për objeksionet që ju keni fokusuar që në momentin e miratimit të ligjit për mbrojtjen civile, e cila është një bazë shumë e rëndësishme dhe themelore për ngritjen e mekanizmit të mbrojtjes civile në Shqipëri në përputhje me mekanizmin e mbrojtjes civile europiane. Ne e pamë të gjithë, pavarësisht komenteve, interpretimeve apo këndvështrimeve, reagimin e jashtëzakonshëm të të gjitha strukturave, institucioneve, subjekteve, pse jo dhe të gjithë shqiptarëve, ku pamë një solidaritet, që nuk ishte parë më parë, pavarësisht ngjyrave politikave. Dua të falënderoj, pa përjashtim, të gjithë deputetët prezentë, ata që nuk janë, por edhe të gjithë qytetarët shqiptarë,

të cilët nuk kanë parë në asnjë këndvështrim, por veç se kanë ndërhyrë drejtpërsëdrejti deri në rrënojat për të ndihmuar ato që ishin nën rrënoja, por edhe për t'u ardhur në ndihmë familjarëve të ndryshëm, të cilët ishin pa banesa pas tërmetit të 26 nëntorit, një nga tërmetet me intensitet më të lartë të shkallës rihter prej shumë vitesh.

Sigurisht që ky tërmet, përveç epiqendrës që pati në Durrës, pati rezonancën e vet të përcjellë në qarqe të tjera dhe bashki të tjera të Tiranës dhe Lezhës, që janë përfshirë në vendimin e Këshillit të Ministrave për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, por edhe me pasoja të konsiderueshme në qarqe të tjera, të cilët janë jashtë juridiksionit të tri qarqeve të përfshira në këtë vendim. Më duhet t'ju them se të gjitha bashkitë, prefekturat, por edhe institucionet e qarqeve të tjera, të cilët nuk janë brenda këtij juridiksioni kanë përpara ligjin e tyre, ashtu sikurse vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 329, me të drejtën e tyre ligjore dhe detyrimin për t'iu përgjigjur çdo ankese, kërkesë apo edhe shqetësimi të qytetarëve për të ngritur grupe dhe komisione të caktuara me ekspertë inxhinierë për të bërë vlerësimin e dëmeve, kudo qofshin ato, për të përpiluar dokumentacionin, dosjet përkatëse dhe për ta referuar atë, në bazë të ligjit, në bashkitë për kompensimin apo trajtimin përkatës financiar të tyre, ose për ta përcjellë më tej dosjen përkatëse në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Për të theksuar nevojën dhe domosdoshmërinë e zgjatjes së shpalljes së fatkeqësisë natyrore duhet ta përforcoj atë që tha zoti Koçi lidhur me një sërë operacionesh, të cilat janë në vazhdim e sipër dhe përkojnë me të gjitha strukturat operationale, që janë aktualisht në terren, qofshin këto strukturat e Forcave të Armatosura, të cilat janë në një gatishmëri të përforcuar, qofshin ato të Policisë së Shtetit, që gjithashtu janë të angazhuara maksimalisht me të gjitha kapacitetet e tyre për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve si me akomodimin, sigurimin fizik të tyre, shoqërimin dhe marrjen e masave për të siguruar vende të caktuara të akomodimit të qytetarëve në hotele, në qendrat e pritjes, apo edhe në banesa, ku ne kemi mundësuar vendosjen e çadrave në zonat rurale, ku për arsye tashmë të njohura ekonomike dhe objektive familjarë të caktuar janë të akomoduar në kushtet e një jetese, sigurisht jo normale, por në çadra. Të gjitha këto operatione do të vazhdojnë deri në një fazë të vlerësuar të Komunitetit Ndërministror, i cili ka autorizuar dhe me vendim të caktuar ka ngritur shtabin qendror në Durrës, që kryesohet nga ministri Çuçi, si i deleguar i Komitetit Ndërministror, si ministër fuqiplotë. Të gjitha vendimet dhe iniciativat përkojnë, analizohen dhe të gjitha raportet përqendrohen vetëm në këtë shtab, pasi dihet që, në bazë të ligjit, ekskluziviteti i takon vetëm Komitetit Ndërministror si në aspektin e bërjes, hartimit të raporteve, vënies në dijeni, vënies në funksion, por edhe adresimit të gjitha kërkesave të tjera, qofshin këto ndërkombëtare, qofshin edhe brenda për brenda për koordinimin, ndërveprimin

ndërinstitucional dhe të gjitha masat e tjera operationale që merren deri në rehabilitimin e plotë të masave të gjendjes së shpallur të fatkeqësisë natyrore. Në këto kushte, qeveria dhe Komiteti Ndërmintor, duke pasur parasysh se kjo fazë është një nga fazat më të rëndësishme për të identifikuar pikë së pari me akte dhe me vendime konkrete dëmet e ndodhura në të gjitha banesat, apartamentet, apo objektet, apo institucionet, qofshin këto kulturore, shëndetësore dhe arsimore, ky operation do të vazhdojë dhe vlerësimi i takon pikërisht Komitetit Ndërmintor, si autoriteti i vetëm i ligjshëm për të gjithë ecurinë, por edhe vendimmarrjen. Më lejoni të shpreh edhe njëherë gatishmërinë, por dhe përgjegjshmërinë e të gjitha institucioneve që ne kontaktojmë, bashkërendojmë dhe veprojmë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Faleminderit!

Përpara se t'ia kaloj fjalën zotit Zeneli, dua të them diçka lidhur me sugjerimin që bëri zoti Harusha. Në fakt, sugjerimin e zotit Harusha, të një kolegu, e marr si të tillë për faktin që ne nuk jemi pjesë e Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile, nuk jemi as personat që ndjekim në kohë reale punën e këtij komiteti, por sigurisht, është e rëndësishme që propozime të ndryshme që bëhen nga deputetët të mund të vihen në detajet e punës së këtij komiteti. Natyrshëm ka një lloj padurimi, që duhet mirëkuptuar dhe duhet pranuar, nga ana e të gjithë personave banesat e të cilëve janë dëmtuar, për të marrë një përgjigje nëse mund të vijohet jetesat normalisht në ato banesa apo jo. Kërkohej demolimi i tyre, apo kërkohej rikuperimi i atyre banesave, gjë e cila, unë besoj, mund të paraprihet qoftë duke inkurajuar grupet e punës që ato të vazhdojnë punën me përgjegjësi, sipas një radhe të përcaktuar prioriteti. E mira do të ishte që grupet e punës të përforcoheshin dhe të mos kishte vetëm një inspektim, por të kishte të paktën dy inspektime, në mënyrë që të siguroheshin për rezultatin e atyre inspektimeve. Nuk e di nëse në atë lloj prioriteti punë është vendosur që pjesë e atyre inspektimeve, jo në kuptimin teknik të bërjes së inspektimit, por në kuptimin e ndjekjes së inspektimit, të ishte edhe prokuroria, sepse natyrisht ka një debat medietik, por jo vetëm, se fatkeqësitë nuk kanë ndodhur thjesht dhe vetëm për shkak të tërmetit, por po verifikohet që shkak kryesor dhe i drejtpërdrejtë ka qenë natyrisht puna e dobët e bërë me ndërtimin, në mënyrë që të sigurohet që çdo përgjegjës të shkojë dhe të përballet ashtu siç duhet me ligjin. Pra, shqetësimin që kjo pjesë nuk duhet të lihet pas dore, unë besoj se do të mund ta reflektoni më së miri pikërisht në këtë moment kur prokuroria duhet të njoftohet për çdo rast kur grupet e inspektimit shkojnë pranë atyre banesave dhe për çdo rast kur vendoset demolimi ose rikuperimi i tyre. Besoj se kjo do ta ndihmonte më shumë punën dhe asnjë lloj mundi nuk do të shkonte dëm. Pra,

paralelisht të ndiqeshin të dyja këto momente: inspektimet në terren, sipas një radhe prioriteti dhe me grupe pune të përforcuara, dhe njoftimi i organit të ndjekjes penale për ta parë këtë proces, sepse duhet të kuptojmë që edhe ngarkesa për prokurorinë nuk është ajo që ka njohur deri më sot, por është një ngarkesë e shtuar dhe është një praktikë pune krejtësisht e re për prokurorinë, duke marrë parasysh se ka që nga viti 1979 që Shqipëria nuk ka kaluar një fatkeqësi natyrore të tilla përmasave.

Petro Koçi– Lidhur me prokurorinë, nuk është në targetin tonë të përgjigjemi, por dua të theksoj se kam qenë në Thumanë që në orët e para të fatkeqësisë dhe aty kam parë prezencën e prokurorisë së rrethit përkatës, madje nga ajo që kam parë dhe me dijenitë teknologjike që kam unë lidhur me ndërtimin, kam deklaruar se tullat silikatë që ishin rrëzuar ishin sikur sapo kishin dalë nga fabrika, pra s’kishte material ngjitës, llaç, dhe ish-llaçi ishte kthyer i gjithi në rërë dhe dukej që materiali lidhës ka qenë shumë i dobët. Gjithsesi, ky nuk është një konkluzion ligjor, është konkluzion qytetar, por prokuroria ka qenë atje dhe besoj se ka bërë të njëjtën praktikë gjithandej.

Për sa i përket kërkesës së zotit Harusha, mendoj se në rastin e Shkodrës nuk kemi një dëm të një shkalle shumë të madhe, që do të kërkonte asistencë nga jashtë Bashkisë Shkodër. Sipas ligjit, janë ekspertët e urbanistikës dhe inxhinierët e ndërtimit të asaj bashkie që bëjnë vlerësimin paraprak nëse banesa është e banueshme apo jo, pastaj bëhet një raund tjetër, që ka lidhje me vlerësimin e dëmeve. Ky është një proces ligjor dhe me shumë përgjegjësi, sepse nuk mund t’i hedhësh një sy dhe thuash që kjo banesë nuk bëhet më dhe futesh të përcaktosh dëmin, por duhen ekspertë, të cilët përcaktojnë qartazi se cila është përmasa e dëmit, bëhet llogaritja e dëmshpërblimit nga bashkia dhe, nëse duhet, nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Pra, nëse atje nuk ka dëme të përmasave të mëdha, nuk besoj se është e nevojshme, sidomos tani që ekipet janë të angazhuara në zonat që janë brenda juridiksionit të bashkive dhe qarqeve të shpallur gjendje e fatkeqësisë natyrore...

Luan Harusha- Zoti Koçi, bashkia ka bërë një grup inspektimit, nuk e di se sa inxhinierë, ku ka bërë inspektimet dhe i ka përcjellë, por ky grup inspektimi nuk është i vlefshëm, sepse ka një komision tjetër që e vlerëson.

Haki Çako – Në bazë të ligjit, komisionet e konstatimit janë komisionet paraprake, ajo që tha zëvendësministri, dhe ngrihen me një vendim të posaçëm të kryetarit të bashkisë dhe të këshillit bashkiak, të cilët janë të përbërë me inxhinierë ekspertë, qofshin këta arkitektë, urbanistë apo inxhinierë të tjerë ndërtimi. Këta bëjnë vlerësimin teknik dhe ekspertimin e objektit në fjalë. Ata bëjnë një preventiv të përcaktuar qartë për të gjitha dëmet e shkaktuara. Ky është akti ligjor përfundimtar, i cili përcakton të gjithë nevojën për të bërë

rehabilitimin, në qoftë se bëhet fjalë për dëme të kategorisë së rënda apo të lehta, apo vendimmarrjen përfundimtare për ta asgjësuar si objekt për të marrë një vendim tjetër për të rindërtuar. Ky vendim konsolidohet në këshillin e bashkisë me një unanimitet, sipas procedurave me akt.

Luan Harusha- Është bërë kjo procedurë dhe është përcjellë, por përgjigja është që duhet komisioni vlerësues i specialistëve.

Ermonela Felaj- Në qoftë se ata kanë kërkuar ndihmë të specializuar, besoj se nuk ka për të munguar. Ne nuk e kemi aktin përpara që të flasim, por, sidoqoftë, kjo është logjika. Në qoftë se ka nevojë për ndihmë më të specializuar, nuk mund të mohohet.

Haki Çako- Vetëm nëse ka kontestime në bazë të ligjit ngrihet një komision tjetër për të bërë rivlerësimin e punës së bërë nga ai komision. Komisioni ngrihet nga prefekti me një vendim të caktuar dhe bën rivlerësimin, nëse ka debate apo diskutime, në të kundërtën, nëse ky komision vlerësimi ka dalë me një akt, ku ka preventiv, përlllogaritje dhe konkluzion, ky është një vendim i ligjshëm.

Ermonela Felaj- Besoj se shpjegimi është i qartë dhe rastet duhen ndjekur në mënyrë praktike. Fjalën e ka zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Faleminderit, zonja Kryetare!

Normalisht do të ishte më e mira që në këtë komision të nderuar, me këtë propozim të qeverisë që ka ardhur për shtyrjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të datës 26 nëntor, të ishim më konkretë. Falënderimet për njeri-tjetrin, siç bëjmë ne, anëtarët e komision, për deputetët e pozitës, opozitës apo për ju, për mua është e pavend, sepse ne e kemi për detyrë atë që kemi bërë, po bëjmë dhe duhet të bëjmë.

Në rastin konkret ju na keni sjellë një propozim dhe ndihma jonë do të jetë vetëm miratimi i këtij propozimi, për t'u ardhur në ndihmë gjithë qytetarëve shqiptarë.

Për mua, falënderimi duhet të jetë për të gjithë shqiptarët që u solidarizuan me këtë fatkeqësi kaq të madhe!

Falënderimi duhet të jetë për vëllezërit tanë kosovarë, për miqtë tanë anembanë botës, që u solidarizuan me fatkeqësinë në Shqipëri!

Çdo fjalë tjetër është vetëm retorikë politike. Unë e mbështes kolegun Maliqi kur thotë se retorika politike në këtë rast është veçse boshe dhe absolutisht nuk u ofron asnjë gjë qytetarëve shqiptarë, të cilët janë sot në ditët e hallit për shkak të kësaj fatkeqësie.

Disa retorika (ju, zoti zëvendësministër, me kolegun Maliqi) për paralelizma të fatkeqësive të tanishme, por edhe atyre të kaluara, i gjej totalisht të pavend. Absolutisht, edhe në rastin e kësaj fatkeqësie, nuk është as vendi dhe as koha të vendosim se e kujt është

përgjegjësia. Fatkeqësia ka ardhur për shkak të Zotit apo të natyrës. Patjetër që ka edhe përgjegjësi penale dhe ligjore, por nuk është as koha, as vendi këtu. Janë organet e drejtësisë ato që do të vendosin se kush është përgjegjës për këtë.

Prandaj, u kërkoj gjithë kolegëve të opozitës ta miratojnë këtë shtesë të afatit që keni kërkuar ju si qeveri.

Kisha edhe një pyetje për ju, zoti zëvendësministër, në emër të qeverisë.

Këtu kemi edhe qarqe të tjera të vendit, që janë prekur më së shumti nga ky tërmet. Unë vij nga qarku i Kukësit, ku nuk keni përcaktuar se çfarë dëmsh ka. Nga informacionet që kam unë dëmet janë shumë të mëdha.

Cila është arsyeja që ju i keni caktuar qarqet si Tirana, Lezha dhe Durrësi dhe nuk keni paracaktuar as Kukësin, as Dibrën, as Fierin, as Elbasanin, as Beratin, në një kohë kur thoni se edhe këtu kanë pasur dëme të konsiderueshme?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Siç e dini, para 26 nëntorit ka pasur edhe dy tërmete të tjerë brenda vitit. Një tërmet ka rënë më 1 qershor në qarkun e Korçës dhe tërmeti i 21 shtatorit, që preku Durrësin dhe Tiranën. Në të dyja rastet paraprake nuk pati shpallje të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, sepse gjithçka llogaritet në përputhje me përmasat e fatkeqësisë, pra të dëmeve dhe mundësive institucionale për t'iu përgjigjur fatkeqësisë. Në të dyja rastet e mëparshme nuk ka qenë e nevojshme të bëhej shpallja e fatkeqësisë natyrore, në mënyrë që të kishim, po themi, edhe shtrëngime ligjore ndaj subjekteve të ndryshme shtetërore apo private për t'iu përgjigjur situatës, sepse ishte e mjaftueshme të përballohej kjo situatë me kapacitetet që angazhohen jashtë atyre që angazhohen kur shpallet fatkeqësia natyrore.

Në rastin konkret, përmasa e dëmeve në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, është e tillë që u gjykua e nevojshme të shpallej gjendja e fatkeqësisë natyrore.

Në qarqet e tjera dëmet e shkaktuara nga i njëjti tërmet nuk janë të përmasave të tilla që të justifikojnë propozimet dhe pastaj vendimmarrjen për të shpallur gjendjen e fatkeqësisë natyrore, por edhe në këto raste, qeveria, ashtu siç bëri për tërmetin e 1 qershorit në Korçë dhe për tërmetin e 21 shtatorit në Tiranë dhe në Durrës, do të marrë masat e nevojshme në përputhje me ligjin, për t'iu përgjigjur çdo lloj dëmi dhe çdo lloj rasti që kërkon një ndërhyrje, në mënyrë që jeta e banorëve apo e familjeve të dëmtuara të kalojë në normalitet.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Keni një pyetje tjetër?

Alban Zeneli– Po, kam një pyetje më konkrete, nëse ju e keni... Meqenëse është edhe drejtori i Emergjencave këtu, zoti Çako, a keni ju një raport të hollësishëm për dëmet që janë bërë sidomos gjatë tërmetit të 26 nëntorit në qarkun e Kukësit?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Çako.

Haki Çako – Ne jemi në pritje të raporteve përfundimtare të shtabeve të të gjitha qarqeve. Sikurse e tha edhe zëvendësministri, shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme për tri qarqet përkon me nevojën për të angazhuar masa të jashtëzakonshme ose masa që përkojnë me gjendjen e fatkeqësisë natyrore. Jo se qarqet e tjera, ku ka dëme, janë nënvlerësuar, por duke pasur parasysh që normaliteti ndryshon në këto qarqe, raporti përfundimtar është një proces që kërkon kohën e vet tek të gjitha komisionet përkatëse, që janë ngritur në të gjitha qarqet, që nga bashkitë, dhe përqendrohen përfundimisht te prefekti, i cili e vë në dispozicion raportin përfundimtar. Prandaj del e domosdoshme që edhe zgjatja e kësaj gjendjeje të fatkeqësisë natyrore të kërkohej në limitet e përfundimit të përcaktuar kushtetues e ligjor prej një muaji, të vendosur nga qeveria dhe funksionimi i komunitetit ndërministror do të jetë aktual, ashtu sikurse edhe komisionet përkatëse në të gjitha qarqet e tjera, të cilat kanë pasur realisht dëme.

Është e vërtetë që ka pasur dëme në disa qarqe, në Kukës, Dibër, Shkodër, Elbasan, Fier. Këto janë qarqe që janë goditur, e thashë edhe më parë, nga rezonanca e tërmetit të 26 nëntorit, por pasojat nuk përkojnë me volumin, ashtu sikurse dhe dëmi maksimal në humbje jetësh njerëzish ishte i përqendruar (besoj se të gjithë jemi koshientë për këtë) më shumë në Durrës dhe në Bashkinë e Krujës, më saktë, në Thumanë. Dëme materiale ka pasur edhe Tirana dhe Lezha, por fatmirësisht nuk patën humbje jetësh.

Gjithsesi, të gjitha dëmet e shkaktuara në të gjitha qarqet do të trajtohen konform ligjit, pa neglizhuar asnjë rast.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit edhe juve! Kjo është e rëndësishme.

Fjalën e ka zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Do të jem i kujdesshëm dhe do të flas shkurt, pasi me problemet e ngritura qoftë nga opozita, qoftë nga krahuri i maxhorancës, me relatimin që u bë nga kolegu dhe me atë që tha zëvendësministri, jemi dakord. Gjëja primare këtu është nëse e japim apo nuk e japim pëlqimin, dhe nga diskutimet e kolegëve është dhënë pëlqimi për të zgjidhur afatin për gjendjen e fatkeqësisë natyrore.

Nuk është momenti këtu për ta politizuar. Madje, shumë nga kolegët që kam përballë, kolegë të tjerë të opozitës, natyrisht, edhe të maxhorancës, kanë qenë bashkërisht në terren. Do të ishte me shumë interes për të ndikuar në gjendjen e përgjithshme të atyre njerëzve të shikojnë që edhe liderët kryesorë të politikës të jenë bashkë. Ashtu sikurse ishte Kryeministri që në orën 05:00, do të ishte mirë të ishte edhe zoti Basha, ashtu siç ndodhi, po të kthehemi në retrospektivë, me fatkeqësinë në Gërdec (e kemi parasysh që Partia Socialiste ishte në opozitë dhe iu gjend në krah pavarësisht se kush ishin fajtorët).

Në këtë kuadër, dua t'u them edhe kolegëve, të cilët atakuan të ashtuquajturin *show* të Kryeministrit, që nuk më duket aspak *show*, sepse për një *show* duhet të përgatitesh, siç e tha edhe zëvendësministri, gjatë. Duhet të përgatitesh gjatë për ta nxjerrë atë në skenë për ata që shikojnë gjysmë ore apo një orë. Në fakt, kjo përgatitje e gjatë ka ndodhur ndryshe me këtë maxhorancë.

Ne si Komision Sigurie i kemi marrë masat dhe dua t'i falënderoj të gjithë kolegët që i paraprinë miratimit të këtij ligji, që është shumë i vlefshëm sot!

Nuk mund të quhet *show* i Kryeministrit, kur e fillon mbledhjen e qeverisë në orën 05:00 të mëngjesit dhe e mbyll në orën 01:00 apo 02:00 të mëngjesit. Nuk mund ta quajmë *show* të Kryeministrit, kur ai nuk pushon, për t'i sinkronizuar dhe për t'i bërë të gjithë bashkë donatorët vendas. Nuk mund ta quajmë *show* të Kryeministrit, kur në samitin e NATO-s ai takon të gjithë liderët që marrin pjesë aty dhe e ndërkombehtarizon problemin. Nuk mund ta konsiderosh *show* të Kryeministrit, kur ai ka ndërmarrë nismën për të mbledhur donatorët e Bashkimit Europian. Pra, duhet të solidarizohemi dhe të bëhemi të gjithë bashkë, sepse këtu njerëzit nuk ndahen në të majtë e në të djathtë, ashtu siç nuk u ndamë edhe ne këtu në komision, për t'u gjendur pranë qytetarëve.

Edhe ai gjesti, që duket si një gjest thjesht për t'u parë dhe ndoshta honorifik, siç ishte rasti i dërgimit të atyre dy fëmijëve, që u hodhën nga kati i pestë për të shpëtuar dhe u dërguan në Itali thjesht për t'u plotësuar një dëshirë, nuk ishte *show*, por ishte për t'u dhënë njerëzve mesazhin se jeta vazhdon. Fatkeqësia ishte e rëndë, ishte e madhe, por ata fëmijë kanë shpresë. Ata kanë shpresë për ta vazhduar sërish shkollën, siç kanë shpresë edhe qytetarët, që kanë humbur të afërmit e tyre, se do të fillojnë të rikuperohen gradualisht.

Prandaj, zonja kryetare, mendoj se, ashtu siç e kemi treguar veten si Komision Sigurie, do të gjendemi sërish bashkë, jo thjesht për të dhënë pëlqimin, por edhe në këto ditë, kur po vazhdon rindërtimi i shtëpive apo ndërtimi i shtëpive të reja. Të jemi përsëri bashkë, për ta nxjerrë Shqipërinë... Shqipëria do të ringrihet përsëri dhe ne do të jemi pranë

qytetarëve, ashtu siç jemi në çdo moment dhe në çdo fatkeqësi, pse jo, duke shkuar bashkë, edhe si Komision Sigurie, për t'i parë nga afër, ashtu siç kemi shëtitur edhe në vende të tjera.

Ky është një apel që i bëhet gjithë politikës në këtë periudhë.

Ndaj, gjej edhe një herë rastin t'ju falënderoj ju, zoti zëvendësministër, dhe ju, zoti drejtor!

Gjej rastin të falënderoj të gjitha forcat, të gjithë individët, që erdhën nga ushtritë e tjera dhe nga forcat e tjera të emergjencës, sidomos vëllezërit kosovarë, por edhe fqinjët tanë serbë, maqedonas, rumunë, francezë, italianë!

Kushdo që kontribuoi dhe na u gjend në këto momente ka një falënderim nga gjithë populli shqiptar, pse jo, edhe nga ne si komision!

Ju faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ju lutem! Të mos bëjmë komente për njëri-tjetrin, se nuk shkon! Ne jemi për këtë... Ju thatë atë që mendoni, ai tha atë që mendon. Unë besoj se ne si komision duhet të qëndrojmë mbi cicmicet e ditës.

Alban Zeneli – Patjetër. Në shumë gjëra që tha...

Ermonela Felaj – Pavarësisht se si e mendoj unë, pavarësisht se çfarë gjykimi kemi për secilin, ne kemi një pozicion të veçantë dhe besoj se ajo që do të ndihmonte më shumë në këtë rast është që atë që përbën vërtet një alternativë mendimi, të mund t'ia ofronim qeverisë në punën e saj për përballimin e këtyre pasojave. Kjo do të ishte gjëja e duhur që mund të bënim ne nga ky vend pune. Përtej kësaj, sigurisht që sjelljet tona janë të orientuara edhe nga fakti se çfarë përfaqësojmë ne dhe çfarë jemi në vetvete.

Alban Zeneli – Dy gjëra që...

Ermonela Felaj – Më lejoni t'ia jap fjalën zonjës Malo dhe pastaj do t'ju jap fjalën për një koment të fundit. Më pas do të kalojmë në votim.

Artemis Dralo Malo – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Shumë shkurt, për të mos përsëritur të njëjtat gjëra, pikësëpari dua të falënderoj për gatishmërinë e treguar në kohë rekord jo vetëm qeverinë, komitetin ndërministror dhe këshillin e ngritur, por edhe shqiptarët kudo që janë, përtej kufirit, për gatishmërinë dhe solidaritetin maksimal përtej çdo bindjeje politike, qëndrimi apo ngjyrimi të mundshëm!

Këto ditë Shqipëria ka pasur nevojë për të qenë sa më e bashkuar. Për këtë u jam mirënjohëse shqiptarëve në të gjitha vendet ku jetojnë, sepse me mundësitë e tyre të gjithë kanë qenë bashkë, janë ofruar dhe kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm!

Kam vetëm 2 kërkesa.

Kërkesa e parë ka të bëjë me emergjencat, në aspektin e kërkesave të shumta që na vijnë nga qytetarët e prekur nga tërmeti dhe godinat e tyre nuk janë klasifikuar si më të rrezikshmet apo më shumë të rënduara. Problemi qëndron te pjesa e burokratike. Ata janë të painformuar.

Personalisht, do t'ju sugjeroja të ngihen më shumë *info point*, numra në dispozicion apo zyra në gatishmëri, për t'i orientuar qytetarët, të cilët, pasi e kanë kaluar fazën e parë të inspektimit në kohë rekord (për këtë ju përgëzoj), gjenden përballë një situatë, ku janë të paorientuar se ku duhet të drejtohen, në pritje të së cilës zyrë, të cilit procesverbal, bashki apo njësi. Janë vazhdimisht në kontakt me të gjithë zëvendësministrat përkatës, që kanë marrë njësitë e prekura.

Kërkesën e dytë e kisha për medien dhe organet e tjera të informimit publik, të cilave dua t'u kujtoj detyrimin për t'iu referuar burimeve zyrtare për përshkrimin e njoftimeve të çdo eventi në zhvillimet e ditëve të fundit, jo vetëm për sa u përket parashikimeve të mëtejshme për mundësinë e ndodhjes së ngjarjeve të tjera dhe të situatës, por edhe për referimet zyrtare që marrin nga organet kompetente. Do t'u lutesha të ishin sa më zyrtare dhe sa më të gërshetuara.

Është gjendur rishtazi, dje dhe pardje, edhe emri im në listën e disa prej të arrestuarve në Durrës, gjë që më solli para një situatë shumë qesharake. Me shumë dëshpërim dëshmoj edhe një herë se në çfarë niveli ka arritur informacioni i medieve tona dhe si është transmetuar në mënyrë virale menjëherë ky lajm nëpër titrat e televizioneve, nëpër portalet e ndryshme, gjë që më ka lënë të pajustificueshme, por edhe të shtangur nga mesazhet që merrja vazhdimisht. Kjo është një rikujtesë, për të sjellë përsëri çështjen e antishpifjes, që kaq shumë i ka prekur. Ju lutem, tregoni pak më seriozitet në këto gjëra, aq më tepër për raste kaq sensitive kundrejt njerëzve!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, Artemis!

Po, zoti Çako.

Haki Çako – E nderuar deputete, më lejo të të sqaroj se në lidhje me adresimin e të gjitha ankesave të qytetarëve ka një seri numrash të vënë në dispozicion, që ekspozohen në çdo medie dhe në çdo moment, ashtu sikurse pothuajse të gjithë qytetarët, pa përjashtim, kanë qenë kontaktuar dhe vazhdojnë të kontaktohen nga njësitë administrative të pushtetit vendor. Ne të gjithë e dimë se ku e kemi pushtetin vendor dhe se ku e kemi bashkinë, minibashkinë apo administratën përkatëse.

Artemis Dralo Malo – Pa diskutim, por këtë...

Haki Çako – Të gjithë qytetarët, që kanë pretendime apo problematika, janë të lutur të telefonojnë në numrat që janë ekspozuar, qofshin këta numra fiks apo një sërë numrash të tjerë, që janë aktualisht në dispozicion (nuk mund t'i interpretoj). Lidhur me kontaktet, ata kanë kryetarët e njësive, të lagjes, të fshatit, por edhe grupet e konstatimit. Ata e dinë fare mirë, sepse aktualisht nuk ka asnjë vend ku nuk kanë shkuar grupet. Kanë shkuar pothuajse të gjithë dhe me të gjithë ata kanë pasur kontakte. Kontaktet u janë lënë edhe përgjegjësve të grupeve. Pothuajse në të gjitha banesat, në të gjitha objektet, ata e kanë kontaktin.

Për sa i përket...

Ermonela Felaj – Megjithatë, rastin e ka konkret zonja Dralo dhe mund ta bëjë pyetjen më konkretisht...

Artemis Dralo Malo – Ndjesë! Fikeni pak, që t'ju sqaroj, ju lutem!

Haki Çako – Po...

Ermonela Felaj – Ndoshta pyetja ishte në mënyrë të përgjithshme.

Artemis Dralo Malo – Nuk ishte kjo, pa diskutim. Unë kështu e nisa, madje duke ju falënderuar për gatishmërinë dhe për përgjigjen në fazën e parë, ku është inspektuar dhe vlerësuar çdo objekt e çdo banesë.

Sugjerimin e kisha për përcjelljen e qytetarëve mbasi bëjnë kontaktin e parë, që kalon nga telefoni në telefon, nga emri në emër, nga zyra në zyrë. Të gjithë këta qytetarë janë në pritje se kur do të futen në një godinë me qira, se ku duhet akomodohen dhe gjenden të gjithë përballë faktit “ku të gjejmë një mik e ku të gjejmë një njeri që të na e zgjidhë këtë punë”. Nuk funksionon kështu. Duhet ta shmangim burokracinë e përcjelljes nga një zyrë në zyrën tjetër. Këtë doja të thosha, sepse e kam pasur konkrete këtë kërkesë nga shumë qytetarë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Më duket rationale ajo që propozon zonja Malo.

Haki Çako – Me të drejtë.

Ermonela Felaj – Sa më pak përcjellje, aq më mirë do të jetë...

Haki Çako – Për sa u përket referencave medietike, nuk janë kompetencë imja.

Artemis Dralo Malo – Nuk ishte për ju.

Haki Çako – Nuk e di se çfarë lapsusi është ky, por jam i sigurt...

Ermonela Felaj - E kishte me medien, jo me ju.

Haki Çako - Kjo që thatë ju e bën të domosdoshëm miratimin sa më shpejt të ligjit.

Artemis Dralo Malo – E kam personale.

Ermonela Felaj – Po, edhe vota personale është.

Po, zoti Zeneli.

Alban Zeneli – E gjej me vend shqetësimin e zonjës Dralo për adresimin e problemeve, që të mos jenë të anashkaluara apo që njerëz të ndryshëm të futen në mënyrë miqësore për të marrë benefitet e rastit të fundit, por kisha një vërejtje dashamirëse për kolegët. Me zotin Qefalia jam koleg, por vijmë edhe nga i njëjti profesion dhe shpeshherë biem dakord për shumë gjëra.

Do t’u kërkoja, sidomos kolegëve të maxhorancës, ta ruajnë mirënjohjen, respektin apo konsideratën për Kryeministrin e tyre në mbledhjet e partisë. Është e pavend që këtu të dëgjojmë retorika të tipit “kryeministri po lodhet aq shumë”. Së pari, Kryeministri i vendit e ka për detyrë të punojë, ashtu siç e kemi edhe ne për detyrë të vijmë këtu dhe me ndihmën tonë të bëjmë ligje, që shqiptarëve t’ua bëjmë jetën sa më të lehtë dhe sa më të mirë.

Ju lutem, nuk jemi në mbledhje partie këtu! Ne jemi në Komisionin e Sigurisë dhe kolegët duhet ta ruajnë konsideratën që kanë për Kryeministrin e vendit. Do të ishte shumë më me vend që Kryeministri Rama t’i merrte falënderimet, minimalisht, edhe nga ne, por më së miri t’i merrte nga qytetarët shqiptarë. Vetëm në atë rast do të quhej se ai falënderim është nga shpirti, nga zemra, kurse në këtë rast, pa dashur t’i ofendoj kolegët e mi, është hipokrizi dhe thjesht një retorikë politike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, është retorikë politike!

Falënderimi u takon gjithë punonjësve të administratës, që kanë punuar në mënyrë heroike, ndoshta edhe pa bazën e duhur logjistike, ndoshta të munguar, për shumë arsye, jo thjesht nga ju, sepse mungesa e logjistikës në institucione të ndryshme është një vazhdimësi 30-vjeçare!

E thashë edhe në fillim, falënderimi shkon për të gjithë shqiptarët që janë solidarizuar me këtë fatkeqësi kaq të rëndë që u ka rënë shqiptarëve!

Faleminderit!

Ermonela Felaj –Megjithatë, të gjithë e dimë se fjala thyen gurë. Kështu, një fjalë e mirë në një situatë të tillë shërben vetëm për të optimizuar njerëzit dhe për t’u dhënë atyre shpresën se kjo situatë nuk mund të kalohet e vetme dhe nuk do të kalohet e vetme. Kujtdo, që ka nevojë për t’i qenë pranë dikush, ndihma nuk do t’i mungojë. Kjo është e sigurt.

U lutem kolegëve të kalojmë në miratimin e projektvendimit.

Paraprakisht do të doja të bëja një sugjerim për përmbajtjen e projektvendimit. Në përmbajtje të projektvendimit të shtohet që propozimi për zgjatjen e afatit të fatkeqësisë natyrore i referohet vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019, “Për

shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”. Pra, një korrektim i vogël, për të kuptuar që kemi tanimë një gjendje të shpallur të fatkeqësisë natyrore, sipas një të drejte, që qeverisë i është njohur me Kushtetutë, por kjo e drejtë është e limituar në kohë, sepse shkon deri në afatin 30-ditor, ndërkohë që për zgjatjen e afatit më tej Këshilli i Ministrave është i detyruar të marrë pëlqimin e Kuvendit të Shqipërisë, pëlqimin tonë paraprakisht. Me këtë sistemim të vogël të përmbajtjes së projektvendimit...

Petro Koçi – Kam një sqarim teknik.

Ermonela Felaj – Po...

Petro Koçi – Janë dy vendime që ka marrë qeveria për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, sepse për Lezhën është marrë më vonë. Prandaj, le të shmanget kjo... Do të detyrohemi t’u referohemi të dyja vendimeve.

Ermonela Felaj – Në përmbajtje është shkruar “të ndryshuar”, sepse ju keni ndryshuar vendimin e datës 27, për të shtuar si qark, në qarqet ku është vendosur gjendja e fatkeqësie natyrore, edhe qarkun e Lezhës.

Kështu që po ua lexoj të plotë kolegëve dhe juve para se ta votojmë.

Kush është dakord me miratimin e projektvendimit “Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të shpallur me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë,” të ndryshuar”, deri në datën 31.3.2020”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është te pjesa “të ndryshuar”.

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kolegë, ju faleminderit për gjithë vëmendjen dhe durimin tuaj gjatë kësaj dite!

Faleminderit edhe kolegëve të Ministrisë së Mbrojtjes!

MBYLLET MBLEDHJA